

URDHËR
Nr. 228, datë 20.2.2024

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR NDJEKJEN E PROCESEVE PËR
NËNSHKRIMIN E URDHRAVE TË LËSHIMIT TË LEJEVE (*DIPLOMATIC
CLEARANCE*) PËR HYRJEN, ULJEN E KALIMIN E MJETEVE LUNDRUESE
USHTARAKE, TË MJETEVE FLUTURUESE USHTARAKE DHE MJETEVE TË
TRANSPORTIT, DHE/OSE TË BLINDUARA USHTARAKE TË HUAJA, NË
HAPËSIRËN AJRORE, DETARE DHE TERRITORIALE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit të ndryshuar; të nenit 22 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 13.6.2007, “Për procedurat e lëshimit të lejeve (*diplomatic clearance*) për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit, dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Enkelejdi Joti, i delegohet kompetenca për nënshkrimin e urdhrave të lëshimit të lejeve (*diplomatic clearance*) për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit, dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë”.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi